



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 41, datë 27.01.2023

PËR

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT
2017-2019, PËR GJYQTARIN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 27.01.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Brikena Ukperaj dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...},

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr. 645 datë 23.12.2020 “Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021”, me vendimin nr. 177, datë 29.04.2021, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit, relatore znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Në datën 05.05.2021, në bazë të neneve 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin, gjyqtari është njoftuar nëpërmjet postës elektronike për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre ose të çdo anëtarit të Këshillit. Në datën 06.05.2021, gjyqtari, nëpërmjet postës elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka shprehur dakordësinë për vlerësuesit e përcaktuar.

Me shkresat nr. 2076/1 prot., datë 10.05.2021, nr. 2076 prot., datë 10.05.2021 dhe nr. 2111 prot., datë 11.05.2021, është kërkuar përkatësisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës dhe ILDKPKI, informacioni dhe raportimi përkatës lidhur me të dhënat që përbëjnë burime vlerësimi në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, në kuptim të nenit 77 të Ligjit për Statusin.

Në datën 20.06.2021, gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës, i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”.

Me urdhrin me datë 10.06.2021, relatori ka disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit për periudhën e vlerësimit 2017-2019, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të shortit. Urdhri i është njoftuar gjyqtarit, kryetarit të gjykatës, si dhe kancelarit të gjykatës, nëpërmjet postës elektronike. Bazuar në urdhrin e relatorit, më datë 14.06.2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim.

Pas zhvillimit të shortit, ka vijuar procedura për formimin e dosjes së vlerësimit, nëpërmjet administrimit të dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe hartimin e raportit analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, ka rezultuar se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.474, datë 12.11.2021, ka vendosur:

- 1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*
- 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore 64 dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.*
- 3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.*
- 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.*

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, mbështetur në nenin 62, nenin 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 66, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, me vendimin nr.88/2 prot., datë 11.01.2022 ka vendosur:

- 1. Pezullimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, të filluar me vendimin nr. 177, datë 29.04.2021, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë.*
- 2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.*
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim para Mbledhjes Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda 10 ditëve nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit, sipas parashikimeve të nenit 191, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar”.*

Vendimi “Për pezullimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të Gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019”, i është njoftuar gjyqtarit me shkresën nr.88/3 prot., datë 14.01.2022. Ndaj këtij vendimi të Komisionit gjyqtari nuk ka bërë ankim para Mbledhjes Plenare.

Mbi ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit {...} kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr.161,¹ datë 15.12.2022 ka vendosur:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 12.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit {...}.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 12.01.2023 ka shqyrtuar propozimin e relatores së procedurës së vlerësimit dhe ka vendosur të miratojë propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, të filluar ndaj gjyqtarit {...}, duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “*Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë*”.

Neni 66, i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “*Vendimi i Kolegjit të Apelit, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm ex lege*”.

Neni 164 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në dispozitat e tij kalimtare, parashikon se: “*1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*”

Këshilli ka miratuar vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ku në nenin 7, parashikohet se: “*Kur Këshilli vendos mbarimin e statusit të një gjyqtari, për veprimtarinë e të cilit ka filluar vlerësimi etik dhe profesional, deklarohet përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar*”.

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

¹ Publikuar në faqen zyrtare të Komisionit të Posaçëm të Apelit <https://kpa.al/njoftim-vendimi-161/>

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, ka rezultuar se gjyqtari {...} ka humbur statusin e magjistratit, për shkak të aplikimit të masës disiplinore të “*Shkarkimit nga detyra*”, dhënë me vendimin nr.474, datë 12.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr.161, datë 15.12.2022.

Ky sanksion i marrë nga organet e rivlerësimit kalimtar në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 164, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në dispozitat kalimtare të tij, passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019, “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në nenin 7 të tij, përcaktohet se mbarimi i statutit të gjyqtarit përbën shkak për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të filluar ndaj gjyqtarit.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe situatën faktike të parashtruar më sipër, Këshilli vlerëson se procedura e vlerësimit të etik dhe profesional për ish/gjyqtarin {...}, e filluar me vendimin nr. 177, datë 29.04.2021, duhet të përfundojë pa vendim përfundimtar, për shkak se si objekti ashtu dhe qëllimi i kësaj procedure vlerësimi është bërë i pamundur për tu realizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 66 të ligjit 84/2016” “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR